



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 08.05.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 05.05.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Vlora A.Ahmeti B.I.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi**“, Nr. i prokurimit- 632-23-2845-2-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: **Vlora A.Ahmeti B.I.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi**“, Nr. i prokurimit- 632-23-2845-2-2-1, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë të AK –së, të datës 26.04.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË**, i publikuar me datë: 26.04.2023;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me procedurat e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

Arsyetim

Operatori Ekonomik Vlora A.Ahmeti B.I me dt.05.05.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi”, Nr. i prokurimit- 632-23-2845-2-2-1.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 08.05.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është i pabazuar, sepse Autoriteti kontraktues nuk ka vendosur limit fiks për paisje siç keni pretenduar ju por është kërkuar minimumi i kapacitetit të litrave për pajisje. Autoriteti kontraktues vendos kriteret dhe specifikat që mendon se janë të nevojshme për kryerjen me sukses të një aktiviteti.

Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, sepse ka kërkuar që automjeti të ketë certifikatë të regjistrimit të automjetit me afat valid, shkelje do të ishte po të mos kërkohej një gjë e tillë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj


Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

